Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 537/13
Datë 24.05.2013

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 24.05.2013 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Për akreditimin e "London Eye" - Prizren, për periudhën: 24.05.2013 -24-05.2015 për të ofruar kurse të gjuhës angleze:

1.1 Akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Trajnim gjithëpërfshirës për ZSC;
- Dokumentacioni i plotë për politikat, procedurat, normat dhe rregullat për sigurimin e cilësisë, përfshirë orarin për mbajtjen e rregullt të ushtrimeve për mbrojtje kundër zjarrit dhe për evakuim;
- Krijimi dhe dokumentimi i një Bordi menaxhues me përgjegjësitë e tyre; fushëveprimin dhe kufizimet;
- Specifikimin e plotë dhe dokumentimin e rolit dhe përgjegjësisë së pronarit/menaxherit;
- Përshkrimi i plotë i vendeve të punës dhe kontrata për të gjithë stafin;

- Trajnim lidhur me kërkesat për akreditim dhe plotësim të dokumentacionit për akreditim;
- Dorëzimi i një Plani 5-vjeçar të Biznesit AKK-së (prej vitit 2013 e tutje), që përfshin masat që do të ndërmerren lidhur me shkallët;
- Përkufizimi dhe identifikimi i vlerësimit të jashtëm për kurse të gjuhës angleze;
- Të ofrojë dëshmi të një politike për zhvillimin e stafit në lidhje me shkathtësitë e mësimdhënies që bazohet në Udhëzimet e AKK-së dhe sistemet efektive për zbatimin e kësaj politike;
- Të siguroj që mësimi dhe vlerësimi të bëhen sipas standardeve të Kornizës së Përbashkët Evropiane.
- Takim monitorues/këshillëdhënës pas afro 6 muajsh për të konstatuar progresin në implementimin e planit për përmirësim/veprim.

1.2. Afati i plotësimit i të gjitha kushteve është deri me 30.08.2013.

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë: 24.05.2013, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë.
Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

2.2. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

3. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

4. Vendimi u dërgohet:

- "London Eye" – Prizren
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi